

FLETUDHËZUES I PAKETIMIT: Informacion për përdoruesin

CUTASON

Tableta – 5 mg
(Prednizon)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Rruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos ja jepni personave të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efektëve anësorë përkeqësohet ose në qoftë se vëreni efekte anësore, që nuk përmenden në këtë fletudhëzues, kontaktoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

- Çfarë është Cutason dhe përsë përdoret
- Përpara se të merrni Cutason
- Si ta merrni Cutason
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Cutason
- Informacion i mëtejshëm

1.ÇFARË ËSHTË CUTASON DHE PËRSË PËRDORET

Cutason është një glukokortikoid (hormoni i gjendrës mbiveshkore) që ndikon në metabolizëm, në bilancin e kripërave (elektrolitëve) dhe në funksionimin e indeve.

Cutason ndikohet në sëmundjet që kërkojnë një terapi sistematike me glukokortikoidë. Në varësi të mënyrës si paraqitet dhe gravitetit të sëmundjes, këtu përfshihen (Tabela me **dozime** nga **a në d** dhe **Dozimi** e, shih pikën 3: Si ta merrni Cutason):

Si terapi zëvendësuese e hormoneve në:

- pamfajtueshmërinë e gjendrës mbiveshkore për shkaqe të ndryshme (si p.sh. sëmundja Addison, hiperplazia kongjenitale e gjendrës mbiveshkore, heqja kirurgjikale e gjendrës mbiveshkore, insuficiencia hipofizare), pasi ka kaluar moshë e rritjes (në këto raste kortizoni dhe hidrokortizoni janë zgjedhja e parë)
- gjendje stresi të shkaktuara nga përdorimi afatgjatë i kortikoidëve.

Çrregullime reumatike:
gjatë fazave aktive të inflamacionit vaskular (Dozimi: a.b):

- poliaritet nodoz (nëse pacienti vuan nga hepatiti B, koha e trajtimit duhet kufizuar në dy javë)
- arteritë me qeliza gigante, dhimbje dhe ngurtësi të muskujve (polimialgji reumatike) (Dozimi: c)
- inflamacion i arteries temporale (arterit) (Dozimi: a), në humbjen akute të shikimit jepen fillimisht doza sulmi glukokortikoidësh endovenë e më pas vazhdohet trajtimi kronik duke mbajtur nën kontroll sedimentimin e eritrocteve
- granulomatoza Wegener; terapi filleshtar (Dozimi: a-b) në kombinim me metotrexat (format e lehta që nuk kanë prekur veshkën) ose sipas skemës Faut) (format e rënda që kanë prekur veshkën dhe i ose mushkërinë), terapi mbajtëse (Dozimi: d, që reduktohet gradualisht) në kombinim me immunosupresantë
- sindroma Churg-Strauss: terapi filleshtar (Dozimi: a-b), kur ka prekje të organeve dhe forma të rënda, në kombinim me immunosupresantë, terapi mbajtëse (Dozimi: d)
- gjatë fazave aktive të sëmundjeve reumatike që prekin organet e brendshme (Dozimi: a, b): lupus eritematoz që prek organet e brendshme, dobësi dhe dhimbje e muskujve (polimioziti), inflamacion i kartilagjos (polychondritis chronica atrophicans), çrregullime të indit lidhor (MCTD)
- artriti reumatoid me zhvillim të shpejtë dhe të rënda (Dozimi: a deri në d) si p.sh. forma shkatërruese të rikthyeshme ose ato që nuk prekin artikulacionet (Dozimi: b)
- sëmundje të tjera reumatike që prekin artikulacionet, nëse sëmundja për nga graviteti kërkon këtë lloj trajtimi dhe nëse disa barna për trajtimin e sëmundjeve reumatike (AIJS) nuk kanë dhënë efekt ose nuk mund të përdoren
- inflamacion i shtyllës kurrizore (spondiloartriti), inflamacion i shtyllës kurrizore (spondilit ankilozant) që prek artikulacione të tjera si ato të kraheve dhe këmbëve (Dozimi: b, c), psoriasis që prek artikulacionet (artriti psoriatik) (Dozimi: c, d), çrregullime gastrointestinale që shoqërohen me inflamacion të rëndë dhe prekin artikulacionet (artropati enteroprotek) (Dozimi: a)
- artrit që vjen si pasojë e një tjetër sëmundjeje ekzistuese (Dozimi: c)
- inflamacion i diabetikoneve që vjen si pasojë e sarkoidozës (Dozimi: b në fillim të terapisë)
- artriti i rëndë që shfaqet pa shkaqe të dukshme tek adoleshentët (artriti juvenil idiopatik) dhe që prek organet e brendshme (sëmundja Still) ose që prek syrin (inflamacion i irisit dhe zonave përreth) dhe nuk i përgjigjet trajtimit lokal (Dozimi: a)
- inflamacion i zemrës në ethet reumatike, në rastet e rënda mbi 2-3 muaj (Dozimi: a).

Sëmundjet e bronkeve dhe të mushkërive:
– astmë (Dozimi: c-a), në të njëjtën kohë rekomandohet ndjekja e një trajtimi bronkodilatator

- përkeqësim akut të sëmundjeve ekzistuese kronike obstruktive të rrugëve të frymëmaries (Dozimi: b), kohëzgjatja e rekomanduar e trajtimit: deri në 10 ditë
- disa sëmundje specifike të mushkërive si: inflamacioni akut i alveolave (alveoliti) (Dozimi: b), ngurtësim dhe rimodelim të indit të mushkërive (fibrozë pulmonare) (Dozimi: b), BOOP (Dozimi: b, që reduktohet gradualisht), mund të kombinohet me barna immunosupresore, pneumoni eozinofike kronike (Dozimi: b, që reduktohet gradualisht), si trajtim mbajtës i formave kronike të sarkoidozës në fazat II dhe III (që shoqërohen me dispne, kollë dhe insuficiencë të mushkërive) (Dozimi: b)
- si trajtim parandalues në sindromën e ankhitit të frymëmaries tek foshnjat e lindura para kohe (Dozimi: b, i përsëritur dy herë)

Sëmundje të rrugëve të sipërme të frymëmaries:
–Forma të rënda të etheve nga bari dhe rinitit alergjik në rastet kur glukokortikoidët të dhënë si spray në hundë nuk kanë dhënë efekt (Dozimi: c)

- ngushtime akute të laringut ose trakesë: angioedemë, laringit obstruktiv (pseudo-krup) (Dozimi: b deri në a)

Sëmundje të lëkurës:

- sëmundje të lëkurës dhe membranave mukozë që për shkak të gravitetit dhe/ose përfshirjes së disa organeve nuk mund të trajtohen në mënyrë lokale me glukokortikoidë Këtu përfshihen:
 - reaksione alergjike dhe reaksione të ngjashme me to, reaksione alergjike të shoqëruara me infeksione: si p.sh. urtikaria akute, shoku anafilaktik
 - sëmundje të rënda të lëkurës, që shkatërrojnë pjesërisht lëkurën, rash-i ndaj barnave, eritema multiforme, nekroza epidermale toksike (sindroma Lyell), pustulosis acuta generalisata, eritema nodoze, dermatosa akute neutrofilike e shoqëruar me temperaturë (sindroma Sweet), dermatiti alergjik nga kontakti (Dozimi: b deri në a)
 - rash-i: si p.sh. rash i shkaktuar nga një reaksion alergjik si dermatiti atopik ose dermatiti i kontaktit, rash i shkakuar nga patogjenë (ekzema numularë) (Dozimi: b deri në a)
 - sëmundje që shoqërohen me shfaqjen e pullave në lëkurë: si p.sh. sarkoidoza, inflamacion i buzëve (granulomatous cheilitis) (Dozimi: b deri në a)
- sëmundje të rënda që shoqërohen me shfaqjen e fluskaeve në lëkurë: si p.sh. pemfigus vulgaris, pemfigusi buloz, pemfigusi beninj i membranave mukozë, dermatosa IgA lineare (Dozimi: b deri në a)
- vaskulli: si p.sh. vaskulli alergjik, poliarteriti nodoz (Dozimi: b deri në a)
- çrregullime të sistemit imunitar (sëmundje autoimmune si p.sh. dermatomioziti, sklerodermia sistematike (në fazën e ngurtësimit), lupusi eritematoz diskoid kronik dhe subakut kutan (Dozimi: b deri në a)
- sëmundje të lëkurës gjatë periudhës së shtatzënisë (shih gjithashtu pikën "Shtatzënia dhe ushqyerja me gj") si p.sh. Herpes gestationalis, impetigo herpetiforme, (Xenidia: d deri në a)
- sëmundje të rënda të lëkurës që shoqërohen me eritemë, rriepje, si p.sh. psoriaza pustulare, pityriasis rubra plaris, grupi i parapsoriasisave (Dozimi: c deri në a)
- eritroderma, edhe e shoqëruar me sindromën Sezary (Dozimi: c në a)
- sëmundje të tjera të rënda: si p.sh. reaksioni Jarisch-Herxheimer ndaj penicilinës gjatë trajtimit të sifilizit, hemangioma kavernoze me zhvillim të shpejtë, sëmundja Behçet, pioderma gangrenoze, fasciiti eozinofik, likeni planus ekanzematik, epidermialoza bluzës e trashëguar (Dozimi: c në a).

Sëmundje të gjakut / sëmundje neoplazike
–sëmundje autoimmune të gjakut:

- anemia e shkaktuar nga shkatërimi i ruazave të kuqe të gjakut nga vetë organizmi (anemia hemolitike autoimmune) (Dozimi: c deri në a)
- purpura trombocitopenike idiopatike (sëmundja Werthof) (Dozimi: a)
- fazat akute të rënies së numrit të pllakëzave të gjakut (trombocitopenia intermitente) (Dozimi: a)
- sëmundje malinje si p.sh.:
 - leucemia akute limfoblastike (Dozimi: e)
 - sëmundja Hodgkin (Dozimi: e)
 - limfoma Jo-Hodgkin (Dozimi: e)
 - leucemia limfocitike kronike (Dozimi: e)
 - makroglobulinemia Waldenstrom (Dozimi: e)
 - mieloma e shumëfishtë (Dozimi: e)
 - nivelet e larta të kalçiumit në gjak si pasojë e një sëmundjeje malinje ekzistuese (Dozimi: c deri në a)
 - parandalimi dhe trajtimi i të vjellave si pasojë e kemioterapisë (Dozim: b deri në a)
- terapia paliative në sëmundjet malinje.

Shënim:
Cutason mund të përdoret në fazat e avancuara të sëmundjeve malinje për lehtësimin e simptomave si: humbja e oreksit, humbja e peshës dhe dobësia e përgjithshme, pasi trajtime të tjera alternative nuk kanë patur sukses.

Sëmundje të sistemit nervor:
–disa forma të paralizës (miasienia gravis), zgjedhja e parë është aziatoprina

- sindroma kronike Guillan-Barré
- sindroma Tolosa-Hunt
- polineuropati si pasojë e gamopatisë monoklonale
- skleroza e shumëfishtë (për zvogëlimin gradual të dozës pasi janë kryer perfuzionet me doza të larta glukokortikoidësh për trajtimin e një ataku akut)
- disa forma epileptike tek foshnjtë (krampet BNS)

Forma progresive specifike të sëmundjeve infektive:
–situata helmimesh në sëmundje të rënda infektive (në kombinim me antibiotikë / kimioterapi), si p.sh. meningjit tuberkular (Dozimi: b), forma të rënda të tuberkulozit pulmonar (Dozimi: b)

Sëmundje të syve (Dozimi: b deri në a)
–sëmundje dhe procese inflamatorë që prekin syrin dhe orbitën e syrit: sëmundjet që prekin nervin optik (neuropati optike, si p.sh. arteritë me qeliza gigante që vjen si pasojë e problemeve të qarkullimit të gjakut ose dëmtimeve), sindroma Behçet, sarkoidoza, orbitopatia endokrine, enjtitja e dukshme e orbitës, reaksioni i fllakës së transplantit dhe disa sëmundje të koroidit si sëmundja Harada dhe oftalmia simpatike.

Në sëmundjet e mëposhtme, Cutason mund të jepet vetëm atëherë kur trajtimi lokal nuk ka qenë i efektshëm:

- inflamacioni i pjesëve të ndryshme të syrit:
- inflamacioni i dermisë dhe indeve përreth i kornesë ose i koroidit, inflamacioni kronik i dhomës përçjegjëse për fommnin e ujit në sy, konjunktivitit alergjik, dëgjiet nga lëndë alkaline, inflamacioni i kornesë që vjen si pasojë e një sëmundjeje autoimmune ose sifilizit (në këtë rast është i nevojshëm një trajtim shtesë kundër patogjenit), inflamacioni i kornesë i shkaktuar nga Herpes simplex (vetëm në rastet kur sipërfaqja e kornesë nuk është e dëmtuar dhe nën kontroll oftalmologjik rigoroz).

Çrregullime gastrointestinale / sëmundje të mëlçisë:
–kollit ulçeröz (Dozimi: b deri në c)
- sëmundje e Krolmit (Dozimi: b)
- sëmundje autoimmune të mëlçisë (hepatiti autoimmune) (Dozimi: b)
- korrozioj i ezofagut (Dozimi: a)

Sëmundje të veshkave:
–sëmundje autoimmune të veshkave: sëmundja Nil (glomerulonefriti me ndryshime të vogla) (Dozimi: a), glomerulonefriti ekstrakapilar proliferativ (glomerulonefriti me zhvillim të shpejtë) (Dozimi: doza sulmi zakonisht në kombinim me barna cistostatikë), për zvogëlimin e dozës dhe përfundimin e trajtimit në sindromën Goodpasture, për vazhdimin e trajtimit afatgjatë të të gjitha formave të tjera (Dozimi: d)
- përhapje të indit lidhor në zonën midis veshkave dhe legenit pa një shkak të përcaktuar (fibroza retroperitoneale) (Dozimi: b).

2. PËRPARA SE TË MERRNI CUTASON

Mos merrni Cutason në:

- keni mbindjeshmëri (alergji) ndaj prednizonit apo ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Cutason.
- Për trajtimin afatshkurtër me Cutason të sëmundjeve që mund të vënë jetën në rrezik, nuk ka kundërrindikacione të mëtejshme (përveç reaksioneve të mbindjeshmërisë të sipërpërmendura).

Tregoni kujdes të veçantë me Cutason

- nëse nevojiten doza më të larta sesa ato të përdorura në terarinë e zëvendësimit të hormoneve.

Në sëmundjet e mëposhtme, Cutason duhet përdorur vetëm nëse mjeku juaj e sheh të domosdoshme.

Trajtimi me tabletat Cutason mund të rishtë riskun e infeksioneve bakteriale, virale, parazitare, oportuniste dhe mykotike nëpërmjet suprimimit të sistemit imunitar. Simptomat e një infeksioni ekzistues ose që është në zhvillim mund të maskohen, duke vështirësuar diagnozën. Infeksionet latente si tuberkulozi ose hepatiti B mund të riaktivizohen.

Njëkohësisht, nëse është e nevojshme, duhet marrë një trajtim shtesë që lufton mikroorganizmin patogjen specifik.

- infeksione virale akute (hepatiti B, Ijia e dheneve, infeksionet nga herpes zoster, infeksionet nga herpes simplex, inflamacioni i kornesë i shkaktuar nga virusi i herpesti)
- infeksione bakteriale akute dhe kronike
- infeksione mykotike (nga kërpudhat) që prekin organet e brendshme
- disa sëmundje të shkaktuara nga parazitët (ameba, infeksionet nga krimbat; në pacientët që dyshohen ose janë të konfirmuar me infektion nga krimbat (Strongyliidae), Cutason mund të shkaktojë aktivizimin dhe shtimin e parazitëve;
- sëmundjet e rryjeve limfatike që vijnë si pasojë e vaksinës ndaj tuberkulozit (në rast se pacientja vuajtur nga tuberkulozi, njëqistish duhet marrë një trajtim me antituberkulare)
- hepatiti infektiv (hepatiti kronik aktiv HbsAg-pozitiv)
- poliomieliti
- 8 javë para dhe 2 javë pas vaksinimit me një vaksinë që përmban mikroorganizma të gjallë.

Gjithashtu, Cutason mund të përdoret në sëmundjet e mëposhtme, vetëm nëse mjeku juaj e sheh të nevojshme dhe nëse këto sëmundje trajtohen njëkohësisht me terapinë sistematike të nevojshme.

- ulcerat gastrointestinale
- hipertensioni vështirësisht i trajtueshëm
- diabeti i rëndë (diabeti mellitus)
- çrregullimet e kokcave (osteoporozja)
- sëmundjet mendore aktuale ose të mëparshme, përfshirë riskun për vetëvrasje; në këtë rast rekomandohet monitorimi neurologjik ose psikiatrik;
- ritnja e presionit intraokular (glaukoma me kënd të ngushtë ose të gjërë); rekomandohet monitorimi i syve dhe terapi e njëkohshme gjithashtu;
- ulcerat ose dëmtimet e kornesë së syrit; rekomandohet monitorimi i syve dhe terapi e njëkohshme gjithashtu.

Duke qenë se ekziston rreziku për çarje të murit të zorrëve (gjë që mund të çojë në peritonit), Cutason mund të përdoret në sëmundjet e mëposhtme vetëm nëse ka arsye të fortë mjekësore dhe nën kontroll të vazhdueshëm.

- inflamacioni i rëndë i kolonit (kolliti ulçeröz) i shoqëruar me perforacion, absces ose qelbëzim
- divertikulti (masë e inflamuar në murin e zorrëve)
- pas disa ndërhyrjeve kirurgjikale (enteroanastomozat), menjëherë pas ndërhyrjes.

Në pacientët që pësojnë perforacion nga ulcera gastrointestinale, dhe që marrin doza të larta glukokortikoidësh, shenjat e irritimit peritoneal mund të mungojnë.

Risku për tendinit dhe çarje të tendineve rritet kur fluorkinolonet (lloj antibiotikësh) dhe Cutason jepen së bashku.

Në fillim të trajtimit me Cutason për miasienia gravis mund të shfaqet përkeqësim i gjendjes. Në këtë rast, përshatja e dozës duhet kryer pranë strukturave spitalore. Duhet patur veçanërisht kujdes gjatë fillimit të trajtimit me Cutason nëse pacienti paraqet probleme të rënda në zonën e fytyrës, fyti dhe insuficiencë në frymëmarrje. Trajtimi me Cutason mund të maskojë shenjat e një infeksioni, duke vështirësuar kështu identifikimin e tij. Trajtimi afatgjatë me prednizon edhe pse me doza të vogla, mund të rishtë rrezikun për një infeksion, përfshirë këtu organizma patogjenë që në kushte të tjera rrallë do ta shkaktonin atë.

Vaksinimi me organizma patogjenë jo të gjallë është i mundur. Megjithatë, duhet theksuar se, doza të larta të Cutason mund të ndikojnë në përgjigjen e vaksinat ndaj vaksinës. Gjatë trajtimit afatgjatë me Cutason, pacienti duhet të kryejë kontrolle të rregullta mjekësore (përfshirë ato okulistike).

Në pacientët diabetikë mund të jetë e nevojshme ritnja e dozës së barnave antidiabetikë (insulina, tabletat e marrja nga goja etj.). Këta pacienti duhet të kryejnë kontrolle të rregullta mjekësore për të mbajtur metabolizmin nën kontroll.

Gjatë trajtimit afatgjatë me doza relativisht të larta të Cutason duhet treguar kujdes që të merret një sasi e mjaftueshme kaliumi (si p.sh. nga zarzavatet, bananet etj.) dhe të kufizohet sasia e kripës. Nivelet e kaliumit në organizëm duhen mbajtur nën kontroll nga mjeku.

Mund të shfaqen reaksione të rënda anafilaktike.

Nëse vuani nga hipertensioni i rëndë ose insuficiencia e rëndë kardiake, duhet të kryeni kontrolle të vazhdueshme tek mjeku, pasi mund të ketë përkeqësim të gjendjes.

Nëse gjatë trajtimit me Cutason kaloni një sëmundje që shoqërohet me temperaturë, pësoni një aksident apo i nënshtroni një ndërhyrjeje kirurgjikale, ju duhet të informoni menjëherë mjekun ose qendrën ambulatorë për trajtimin në fjalë. Mund të jetë e nevojshme një ritnje e përkohshme e dozës ditore të Cutason.

Nëse trajtimi me Cutason zgjat për një periudhë afatgjatë, mjeku duhet t'ju pajisë me një kartë specifike, të cilën duhet ta mbani gjithmonë me vete.

Duke qenë se në varësi të dozës dhe kohëzgjatjes së trajtimit mund të ndodhin çrregullime në metabolizmin e kalçiumit, duhen marrë masa për parandalimin e osteoporozës. Kjo mund të ndodhë veçanërisht në pacientët që kanë disa faktorë rreziku si: trashëgimia familjare, moshë e madhe, marrja e pamjaftueshme e kalçiumit dhe proteinave, pirja e duhanit, konsumi i tepërt i alkoolit, periudha pas menopauzës dhe mungesa e aktivitetit fizik. Për të parandaluar këto çrregullime duhet marrë një sasi e mjaftueshme kalçiumi, vitamine D dhe të kryhet aktivitet fizik. Në rastet e një osteoporozë ekzistente duhet marrë gjithashtu një terapi shtesë e përshtatshme.

Pas ndërprerjes ose përfundimit të trajtimit afatgjatë me Cutason duhet të merren në konsideratë rreziqet e mëposhtme: rritkimi ose përkeqësim i sëmundjes ekzistuese, insuficiencë akute e gjendrës mbiveshkore (veçanërisht në situata ku organizmi është në gjendje stresi si p.sh. gjatë një infeksioni, pas një aksidenti, stresi fizik të rritur), shenja dhe simptoma që vijnë nga ndërprerja e trajtimit me kortizonikë. Në pacientët që trajtohen me Cutason mund të shfaqet sëmundje viranë të rënda. Veçanërisht të rrezikuar janë fëmijët me çrregullime të sistemit imunitar (dobësim të sistemit imunitar) ose personat që nuk kanë kaluar fruthin ose linë e dheneve. Nëse këta persona, gjatë trajtimit me Cutason, bien në kontakt me persona që po kalojnë sëmundjet e sipërpërmendura, duhet të kontaktojnë menjëherë mjekun. Në këto raste mund të jetë e nevojshme të ndërmeret një terapi parandaluese.

Nëse ju shfaqet shikim i turbullt apo probleme të tjera me shikimin, konsultohuni me mjekun.

Njoftoni mjekun përpara se të merrni Cutason nëse vuani nga sklerodermia (e njohur edhe si skleroza sistematike, një çrregullim autoimmune) sepse dozat ditore prej 15 mg ose më shumë mund të risin riskun për një komplikacion serioz të quajtur kriza renale sklerodermike. Shenjat e saj përfshijnë presion të rritur të gjakut dhe prodhim të uritë urinës. Mjeku mund t'ju këshillojë të kontrolloni rregullisht presionin e gjakut dhe urinën.

Fëmijët dhe adoleshentët

Duke qenë se trajtimi me Cutason mund të frenojë rritjen tek fëmijët, ky bar duhet përdorur vetëm nëse mjeku e sheh të nevojshme dhe ritnja e fëmijës duhet monitoruar vazhdimisht. Trajtimi me Cutason duhet të jetë i kufizuar në kohë ose i alternuar (p.sh., një ditë po, një ditë jo [terapi e alternuar].

Të moshuarit

Meqenëse pacientët e moshuar kanë risik të rritur për osteoporozë, raportit përfitim / risk i trajtimit me Cutason duhet të vlerësohet me kujdes.

Pasojat e këqjedorimit për qëllime dopingu

Trajtimi me Cutason mund të japë një përgjigje pozitive në testet për doping. Megjithëse nuk mund të parashikohen pasojat për shëndetin e personave që përdorin Cutason për qëllime dopingu, nuk mund të përjashtohen pasojat e rënda.

Marrja e Cutason me barna të tjera

Njëtori mjekun ose farmacistin tuaj nëse jeni duke marrë/përdorur apo keni marrë/përdorur së fundmi barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetën e mjekut.

Cilat janë barnat që mund të ndikojnë në efikasitetin e Cutason?
Disa barna mund të risin veprimin e Cutason dhe mjeku mund t'ju monitorojë me kujdes nëse jeni duke i marrë ato (përfshirë disa barna për trajtimin e HIV: ritonavir, kobicistat) –barnat që nxisin metabolizimin nga mëlçia (barbituratet, fentoina, karbamazepina, primidoni [për trajtimin e konvulsioneve], rifampicina [për trajtimin e tuberkulozit]): efikasiteti i Cutason mund të zvogëlohet
- efedrina (mund të ndodhet në barnat për hipotension, bronkit kronik, ataket e astmës dhe enjtjen e membranave mukozë të hundës dhe si përbërëse e supresantëve të oreksit); degradimi i përshpejtuar mund të reduktojë efikasitetin e Cutason
- barnat që ngadalësojnë metabolizmin në mëlçi, si p.sh.: disa antitmykotikë (ketokonazol, itrakonazol) mund të risin veprimin e Cutason
- disa hormone seksuale femërore, si p.sh. kontraceptivët: efikasiteti i Cutason mund të rritet
- barna që veprojnë kundër prodhimit të tepërt të aciditelti në stomak (antiacide): bashkëadministrimi i hidroksidit të magnazit ose aluminut mund të rezultojë në përshpejtje të ulët të prednizonit, kështu që këto barna duhet të merren të ndarë nga njëri-tjetri në intervale prej 2 orësh; në pacientët që vuajnë nga sëmundje kronike të mëlçisë mund të jetë e nevojshme ritnja e dozës.

Si ndikon Cutason në veprimin e barnave të tjerë?
Marrja në të njëjtën kohë e Cutason me:

- barna që veprojnë në tonusin kardiak (glikozide kardiake): duke qenë se Cutason mund të shkaktojë mungesë të kaliumit në organizëm, efekti i këtyre barnave mund të rritet;
- barna diuretike dhe laksative: rritet efekti i tyre mbi jashtëqitjen e kaliumit;
- barna që trajtojnë diabetin (antidiabetikë/insulina): mund të zvogëlohet efekti hipoglicemik;
- antikoagulantë (antikoagulantë oralë, derivatat e kumarinave): efekti i tyre mund të dozimohet ose të theksohet;
- barna kundër inflamacionit dhe reumatizmit (salicilatet, indometacina dhe barna të tjerë anti-inflamatorë josteroidë): mund të rritet rreziku për ulçer dhe hemorragji gastrointestinale;

- disa barna që shkaktojnë lëshim të muskujve (relaksantë muskularë [o-depolarizues]: koha e relaksimit të muskujve mund të zgjatet,
- disa barna oftalmologjike (atropina) dhe barna që veprojnë në mënyrë të ngjashme (antikolinergjikë të tjerë): mund të ndodhë ritnja e mëtejshme e presionit intraokular;
- barna për trajtimin e sëmundjeve të shkaktuara nga krimbat (prazikuantell): mund të zvogëlohet efikasiteti i këtij bari;
- antikoagulantë (antikoagulantë oralë, derivatat e kumarinave): efekti i tyre mund të dozimohet ose të theksohet;
- barna kundër inflamacionit dhe reumatizmit (salicilatet, indometacina dhe barna të tjerë anti-inflamatorë josteroidë): mund të rritet rreziku për ulçer dhe hemorragji gastrointestinale;
- disa barna që shkaktojnë lëshim të muskujve (relaksantë muskularë [o-depolarizues]: koha e relaksimit të muskujve mund të zgjatet,
- disa barna oftalmologjike (atropina) dhe barna që veprojnë në mënyrë të ngjashme (antikolinergjikë të tjerë): mund të ndodhë ritnja e mëtejshme e presionit intraokular;
- barna për trajtimin e sëmundjeve të shkaktuara nga krimbat (prazikuantell): mund të zvogëlohet efikasiteti i këtij bari;
- barna për trajtimin e malaries dhe sëmundjeve reumatike (klorokina, hidroksiklorokina, melfokina): mund të rritet rreziku për miopati dhe kardiomiopati;
- hormoni i rritjes (somatropina): veçanërisht doza të mëdha të Cutason mund të zvogëlojë efikasitetin e këtij bari;
- proliferimi (një hormon i trurit të mesëm): frenohet ritnja e hormonit stimulues të tiroides (TSH);
- barnat immunosupresore: përdorimi i njëkohshëm i këtyre barnave me Cutason mund të rishtë ndjeshmërinë ndaj infeksioneve dhe të përkeqësojë infeksionet ekzistues, por që mund të mos jenë zhvilluar ende;
- ciklosporina (përdoret për të frenuar sistemin imunitar të organizmit): rriten nivelet e ciklosporinës në gjak; kjo mund të çojë në ritnje të rrezikut për konvulsione;
- disa barna që përdoren për të ulur presionin e gjakut (ACE inhibitorë): rritet rreziku për diskriz të gjakut;
- fluorokinolonet, një grup antibiotikësh, të cilët mund të risin riskun për rrupturë të tendineve.

Pasojat mbi testet laboratorike
Mund të ulët përgjigjia e lëkurës ndaj testave alergjike.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gj

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni/përdorni çdo bar.

Shtatzënia
Gjatë periudhës së shtatzënisë, ky bar mund të merret vetëm me përshkrimin e mjekut. Informoni mjekun tuaj nëse jeni shtatzënë. Gjatë trajtimit afatgjatë me Cutason në periudhën e shtatzënisë nuk mund të përjashtohen edhe çrregullime në rritjen e fetusit. Nëse Cutason merret në periudhën e fundit të shtatzënisë mund të shfaqet insuficiencë e gjendrës mbiveshkore tek i porrsalindur, që mund të kërkojë terapi zëvendësuese. Në studimet në kafshë, prednizoni ka treguar efekte dëmtesue tek pasardhësit (p.sh. qeljezë e rreze). Diskutohet një risk i rritur i një dëmtimi të tillë tek njerëzit nga administrimi i prednizonit gjatë tre muajve të parë të shtatzënisë.

Ushqyerja me gj

Prednizoni kalon në qumështin e gjirit. Dori tani nuk njihen raste të dëmtimit të fëmijës. Megjithatë, nevoja për administrimin e Cutason gjatë ushqyerjes me gj, duhet shqyrtuar me kujdes. Nëse nevojiten doza të larta të Cutason ju nuk duhet të ushqeni fëmijën me gj. Kontaktini menjëherë me mjekun.

Efektet mbi drejtimin e autometijt dhe përdorimin e makinerve
Dori tani, nuk ka asnjë dëshmi se Cutason ndikon në aftësinë për drejtimin e autometijt apo përdorimin e makinerve. Kjo vlen edhe për personat që punojnë pa një mbështetje sigurie.